



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 849 Prot.

Durrës, më 18.5.2023

VENDIM

Nr 30, datë 18.5.2023

**"Për miratimin paraprak të detajimit të grantit shtesë për vitin 2023, për
Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"**

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e Vitit 2023", Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2, datë 19.01.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, pikës 2/a të Vendimit nr.243, datë 20.04.2023 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar, Vendimit nr.113, datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendimit nr.77, datë 28.01.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të ndryshuar, shkresës nr.8561/1 prot., datë 15.05.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të detajimit të grantit shtesë për vitin 2023, akorduar për përballimin e efekteve financiare të Vendimit Nr.242 dhe Vendimit Nr.243, datë 20.04.2023 të Këshillit të Ministrave, për periudhën 8 mujore prill-nëntor, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOYIROFSKI

